



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE**

**V E N D I M**

**Nr. 730 datë 6.11.2019**

**PËR**

**CAKTIMIN E OFICERËVE KOORDINUES PËR ÇËSHTJET  
E DIASPORËS SHQIPTARE NË KONSULLATAT SHQIPTARE  
NË ITALI DHE GREQI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31, të ligjit nr.23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën , Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare pranë posteve konsullore të Republikës së Shqipërisë, si më poshtë vijon:  
1 (një) oficer koordinues për diasporën për çështjet e arsimit, të drejtësisë dhe të nxitjes së investimeve pranë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Republikën e Italisë;

- 1 (një) oficer koordinues për diasporën për çështjet e arsimit, të drejtësisë dhe të uxiljes së investimeve pranë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Greqi;

- 1 (një) oficer koordinues për diasporën për çështjet e arsimit, të drejtësisë cllie lë nxiljes së investimeve në Konsullatëti e Përgjithshme të Republikës së SUCjipët isë uë Milano, Itali;

- 1 (një) oficer koordinues për diasporën për çështjet e arsimit, të drejtësisë dhe të nxitjes së investimeve në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Selanik, Greqi.

2. Oficerët koordinues do të ushtrojnë funksionin e tyre sipas fushave të mëposhtme:

a) Zhvillimi i marrëdhënieve me komunitetet shqiptare në shtetin pritës në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Diasporës;

b) Identifikimi i nevojave per arsimimin dhe komunikimi me mësuesit e programeve plotësuese të gjuhës e të kulturës shqiptare në bashkëpunim me Qendrën e Botimeve për Diasporën;



c) Nxitja dhe organizimi i bizneseve shqiptare në vendin pritës në bashkëpunim me Dhomën e Biznesit të Diasporës;

ç) Identifikimi dhe asistimi i shtetasve shqiptarë, të cilët vuajnë dënimin me heqje të lirisë në shtetin pritës, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për drejtësinë.

2.1. Përshkrimi i punës, detyrat kryesore dhe mënyra e komunikimit përcaktohen në marrëveshjen e lidhur ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe institucionit propozues. Marrëveshja duhet të përmbajë:

a) pozicionin e punës dhe gradën e emërimit;

b) përshkrimin e punës;

c) afatin e punësimit;

ç) të drejtat dhe detyrimet e nëpunësit.

3. Oficerët koordinues për çështjet e diasporës shqiptare emërohen nga ministri përgjegjës për punët e jashtme pas bashkëpropozimit të ministrit përgjegjës të fiishës që do të mbulojë oficeri dhe ministrit përgjegjës për diasporën. Oficerë koordinues të diasporës mund të përzgjidhen edhe nga jashtë Shërbimit të Jashtëm, të cilët zotërojnë njohuri dhe ekspertizë të spikatur në fushën e arsimit, të drejtësisë dhe të nxitjes së investimeve.

4. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme.

5. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministri i Shtetit për Diasporën dhe ministrinë e tjera të linjës, sipas fushave që do të mbulojnë rast pas rasti oficerët koordinues, referuar fushave të parashikuara në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

MINISTRI I SHETITIT  
PËR DIASPORËN

PANDELI MAJKO

MINISTRI I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ